POLICIA
POLICIA

Si u përgjak datëlindja në Krujë, dy të plagosur me armë zjarri në lokal. I arrestuar edhe pronari i restorantit

09:01, 12/12/2022

A+ Aa A-

Një datëlindje për pak sa nuk u kthye në tragjedi në zonën e Krujës. Një 25- vjeçar ka qëlluar me armë zjarri shokun e tij dhe më pas edhe veten, të cilët fatmirësisht kanë arritur të mbijetojnë.

Policia e Durrësit bëri me dije se autor i dyshuar i ngjarjes është Xhentil Stefa, i cili në gjendje të dehur në një lokal në zonën e Tapizës, ka qëlluar me armë zjarri shokun e tij dhe më pas është vetëplagosur. Mësohet se 25-vjeçari ka qenë në një tavolinë me shokë të tjerë kur një konflikt i çastit ka shpërthyer mes tyre, duke qëlluar me armë zjarri, e më pas ka qëlluar edhe veten.

LEXO EDHE:
'Vjedhje në bashkëpunim'/ Në pranga 1 punonjës i postës, shoqërohen 2 të tjerë, në kërkim 1 tjetër

Arrestimet

Përveç 25-vjeçarit, në prangat e Policisë ka përfunduar edhe një 24-vjeçar, i identifikuar si Hygert Muja, pronari i lokalit, i cili akuzohet nga Policia se ka fshehur armën e krimit si dhe ka zhdukur gëzhojat në vendin e ngjarjes. Në pranga ka përfunduar dhe një 28-vjeçar me inicialet F.K., mik me autorin dhe të plagosurin. Ai akuzohet për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit”.

Pas ngjarjes së rëndë, dy të plagosurit janë transportuar me urgjencë në drejtim të Spitalit të Traumës në Tiranë ku ndodhen jashtë rrezikut për jetën.

“Specialistët për Hetimin e Krimit të Komisariatit të Policisë Krujë kanë arrestuar në flagrancë shtetasin Xh. S., 25 vjeç, për veprat penale ‘Vrasja, mbetur në tentativë’ dhe ‘Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe e municionit luftarak’. Gjithashtu, u arrestua në flagrancë shtetasi H. M., 24 vjeç, pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, për veprën penale ‘Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës’.

Në vijim të veprimeve u arrestua në flagrancë edhe shtetasi: F. K., 28 vjeç, për veprën penale ‘Moskallëzimi i krimit’. Nga veprimet e para hetimore të kryera nga specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Krujë, rezulton se këta shtetas ishin ulur së bashku në të njëjtën tavolinë, në lokalin e shtetasit H. M., në Qerek Tapizë.

Dyshohet se në gjendje të dehur, shtetasi Xh. S., ka nxjerrë një armë zjarri pistoletë dhe në rrethana ende të paqarta, ka plagosur shtetasin L. C. (shok i tij) dhe më pas është vetëplagosur në dorë. Të dy shtetasit e plagosur janë jashtë rrezikut për jetën.

Po nga veprimet hetimore rezultoi se shtetasi H. M., pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, ka fshehur armën e krimit, ka hequr gëzhojat nga vendngjarja dhe ka prishur vendin e ngjarjes”, sqaroi Policia. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë, po vijon punën për dokumentimin e plotë të kësaj ngjarjeje. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për veprime të mëtejshme.

© SYRI.net

Taboola Feed

Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek

megazbritje.al | Sponsored



Puna e ëndrrave tuaja mund të jetë disa klikime larg

Punë nga Shtëpia | Kërko reklama | Sponsored

Deklarata - Plas në PS, Erion Braçe sulmon ashpër Taulant Ballën: Ka urdhëruar...

Deputeti socialist Erion Braçe ka akuzuar kreun e Grupit Parkamentar të PS, Taulant Balla se ka urdhëruar bllokimin e amendamentit që mbron bujkun në raport me …

Syri | Lajmi i fundit

Shtëpitë për të moshuarit nuk janë ato që kanë qenë, dhe mund të jenë më të përballueshme nga sa men

Jetesa e të Moshuarit | Kërko reklama | Sponsored

Kostoja e transplantit të flokëve në Turqi mund t'ju befasojë

Transplantet e flokeve | lidhje te sponsorizu… | Sponsored



Breast Cancer (Many People May Wish They Identified Them…

Breast Cancer Treatment | Search Ads | Sponsored

Zbulohet testamenti i Bruce Willis, aktori i lë vetëm 1% të pasurisë vajzave që ka me Demi Moore

Bruce Willis mendon se vajzat e tij të mëdha, me ish-gruan Demi Moore, mund të kujdesen për veten e tyre, prandaj ai ka lënë një pjesë të vogël të pasurisë së tij. …

Syri | Lajmi i fundit

The World's Smartest Dog Breed Might Not Be The One You Expected

Genius-Story.com | Sponsored

Lexo edhe:

Morën me force 3 adoleshentët mes tyre një femër/ Arrestohen 3 të rinjtë që i dhunuan në dalje të qyetetit

EMRI/ Ekstradohet nga Spanja atentatori tjetër ndaj Dash Gjokës

Atentati ndaj biznesmenit Papa, hetimet: U ndoq për disa ditë, dikush spiunoi

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

më të lexuarat

Morën me force 3 adoleshentët mes tyre një femër/ Arrestohen 3 të rinjtë që i dhunuan në dalje të qytetit

EMRI/ Ekstradohet nga Spanja atentatori tjetër ndaj Dash Gjokës

Atentati ndaj biznesmenit Papa, hetimet: U ndoq për disa ditë, dikush spiunoi

'Vjedhje në bashkëpunim'/ Në pranga 1 punonjës i postës, shoqërohen 2 të tjerë, në kërkim 1 tjetër

VIDEO+EMRI/ Aksident në Fier, makina del nga rruga, shoferi në gjendje të rëndë

Mbi 1900 Ha tokë ende nën ujë në Bashkinë e Shkodrës si pasojë e reshjeve masive

Aksident te ‘Dogana’, ‘Porsche’ përplaset me urbanin

Organizim i lojërave të paligjshme, arrestohet 40 vjeçari në Berat

EMRI/ Arrestohet zjarrvënësi i Komisariatit të Policisë së Elbasanit

Goditën me grushta 3 të mitur/ Arrestohen për plagosje 3 të rinjtë në Cërrik

TË NGJASHME

VIDEO+EMRI/ Aksident në Fier, makina del nga rruga, shoferi në gjendje të rëndë

Goditën me grushta 3 të mitur/ Arrestohen për plagosje 3 të rinjtë në

Cërrik

EMRI/ Arrestohet zjarrvënësi i Komisariatit të Policisë së Elbasanit

Organizim i lojërave të paligjshme, arrestohet 40 vjeçari në Berat

Aksident te ‘Dogana’, ‘Porsche’ përplaset me urbanin

Mbi 1900 Ha tokë ende nën ujë në Bashkinë e Shkodrës si pasojë e reshjeve masive

‘Ëndrra angleze’/ Rrëfimi i emigrantit shqiptar: Si udhëtova 12 orë me gomone

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet.
Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net